



Konkurs për Aplikim: Ekspert për Trajnime në Projektin "Community Trust Building"

Përshkrimi i Projektit: SHPQK, me mbështetje financiare nga UNMIK, është duke implementuar projektin *Community Trust Building*, i cili ka për qëllim forcimin e besimit dhe bashkëpunimit në komunitet përmes trajnimeve dhe mbështetjes direkte për fermerët në fushat e cilësisë së qumështit, menaxhimit të fermës dhe balancimit të racioneve të ushqimit.

Në kuadër të këtij projekti, do të zhvillohen 5 trajnime për temën "Cilësia e Qumështit". Për realizimin e këtyre trajnimeve, SHPQK shpall konkurs për **1 Ekspert për Trajnime** në kuadër të kësaj teme.

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Eksperti do të ketë përgjegjësi për:

- Realizimin e trajnimeve** për fermerët në temën:
 - Cilësia e Qumështit:** Trajnimi për përmirësimin e cilësisë së qumështit dhe rritjen e rendimentit të fermës përmes praktikave moderne të menaxhimit të fermës.
- Krijimi i materialeve trajnimi** për fermerët, duke përfshirë udhëzime praktike dhe teorike.
- Vlerësimi i nevojave të fermerëve** dhe përshtatja e trajnimeve sipas kërkesave dhe kushteve specifike të secilës fermë.

Kualifikimet dhe Eksperienca e Kërkuar:

- Arsimimi:** Diplomë universitare në degët e bujqësisë, përparësi kanë të diplomuarit në drejtimin Mjekësi veterinarë. Studimet postuniversitare janë të preferuara.
- Përvoja e Punës:**
 - Të paktën 2 vjet përvojë në sektorin e bujqësisë, me fokus në menaxhimin e fermave të qumështit.
 - Përvoja në trajnimin e fermerëve ose grupeve të tjera të targetuara është e dëshirueshme.
- Aftësi dhe Kompente:**
 - Njohuri të thella të praktikave më të mira për menaxhimin e fermës dhe cilësinë e qumështit.
 - Aftësi për të zhvilluar dhe ofruar trajnime praktike dhe të bazuara në kërkesa.
 - Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi.
 - Njohuri të mirë të gjuhës shqipe dhe/ose serbe (varësisht nga rajoni i trajnimimit).
 - Përshtatshmëri për të punuar në mjedise multi-kulturore dhe për të trajnuar grupe të ndryshme të fermerëve.

Afati i Aplikimit: Data e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **25.12.2024**, aplikimet duhet të dorëzohen në **info@shpqq.org**.

Dokumentet e Kërkuara për Aplikim: CV e përditësuar.